



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 0800 44 88
info@ukt.al
NIPT L72320033P

Nr. _____ Prot

dt. _____. _____. 2018

SPECIFIKIME TEKNIKE

**"Ndertim rrjet shperndares ujesjellesi ne bllokun qe kufizohet nga rruget:
"Demir Nazeri-Princ Vidi-Gjok Doci"**

UJESJELLES

1 - TË PËRGJITHSHME

1.1 HYRJE

Qëllimi i përgatitjes së këtij kapitulli është sqarimi i kërkesave për Kontraktorin në lidhje me Projektin, Ecurinë e punës konform kushteve teknike të zbatimit, Kontratës, Legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e Punonjësve, të ambientit dhe publikut si dhe detyrimeve që duhet të plotësojë Kontraktori gjatë zbatimit të punimeve.

1.2 DOKUMENTAT DHE VIZATIMET

Të gjitha Vizatimet dhe Dokumentat e tjera teknike që shoqërojnë këtë projekt do të jenë bazë për vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së punës që do të bëhet për zbatimin e këtij projekti. Kontraktori duhet të shqyrtojë Projektin që në fillim të punës dhe përpara lidhjes së Kontratës me Investitorin e Objektivit. Kontraktori do të verifikojë të gjitha sasinë, përmasat, të dhënat teknike dhe detajet e dhëna në Vizatimet dhe Dokumentat Teknike që shoqërojnë këtë projekt. Kontraktori do të marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë në kryerjen e llogaritjeve për sasinë dhe llojet e materialeve, volumeve të punës si dhe pajisjeve të kërkuara për kryerjen e kësaj pune. Cdo ndryshim apo përshtatje me kushtet aktuale të terrenit do të bëhet vetëm në bashkëpunim me Projektuesin ose Supervizorin e Punimeve dhe me aprovim të Investitorit.



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 0800 44 88
info@ukt.al
NIPT L72320033P

1.3 ZËVENDËSIMET

Zëvendësimet e materialeve të specifikuara në projekt do të bëhen vetëm me aprovimin e Supervizorit të Punimeve dhe Investitorit. Këto zëvendësime do të bëhen vetëm nëse materiali i propozuar është me cilësi të njëjta ose më të mira se materiali që do të zëvendësohet. Kërkesa për zëvendësimin e materialeve duhet të shoqërohet me dokumenta që tregojnë cilësinë e materialit të propozuar dhe të dhënat teknike të dhëna nga prodhuesi i këtij materiali. Duhet të kihet parasysh se nuk do të njihet asnjë pagesë shtesë apo ndryshim mbi cmimin njësi të dhënë nga Kontraktori në Ofertën e tij dhe të pasqyruar në Preventivin e objektit që shoqëron Kontratën.

1.4 GRAFIKU DHE METODOLOGJIA E PUNIMEVE

Kontraktori pas shqyrtimit të Projektit dhe gjëndjes aktuale në vend duhet të përgatitë Grafikon e Punimeve dhe Metodologjinë e Punëve sipas të cilave do të punojë për të plotësuar kërkesat e zbatimit të projektit në kohën, sasinë dhe cilësinë e duhur. Grafiku i Punimeve do të paraqesë aktivitetet kryesore që do të bëjë Kontraktori për përfundimin me sukses të punimeve sipas kontratës. Në Grafikon dhe Metodën e punës duhet të përfshihen:

- Mobilizimi dhe Investigimi.
- Furnizimi, Transporti dhe Magazinimi i Materialeve.
- Aktivitetet e Punimeve të dhërave, Punimeve Hidraulike, Punimeve të Betonit, etj.
- Mbrojtja e Punimeve, ambientit dhe publikut.
- Kontrolli laboratorik, Testimi dhe Kontrolli i cilësive se materialeve.
- Kolaudimi dhe marrja në dorezim i objektit, Pastrimi i sheshit të ndërtimit, etj.

1.5 HYRJA NË SHESHIN E NDËRTIMIT

Gjatë të gjithë kohës së zbatimit të punimeve, Kontraktori duhet të organizojë punën për lëvizjen e njerëzve në sheshin e ndërtimit. Sheshi i ndërtimit duhet të jetë i rrethuar me shirita plastike të përshtatshme që njoftojnë publikun për kryerjen e punimeve në këtë shesh. Kontraktori nuk duhet të lejojë hyrjen në sheshin e ndërtimit të personave që nuk kanë lidhje me ndërtimin e objektit. Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për çdo problem që mund të ndodhë në sheshin e ndërtimit gjatë gjithë kohës së ndërtimit të objektit. Kontraktori është përgjegjës për sigurinë, qëndrueshmërinë si dhe kullimin e ujërave sipërfaqësore në sheshin e ndërtimit. Kontraktori duhet të organizojë punën për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve hyrese në sheshin e ndërtimit kur shihet e nevojshme prej tij ose supervizorit të punimeve.



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 0800 44 88
info@ukt.al
NIPT L72320033P

1.6. FURNIZIMI ME UJE

Uji që nevojitet për zbatimin e punimeve do të merret nga Rrjeti kryesor nëpërmjet një matësi në pikën më të afërt të mundshme. Kontraktori do të shtrijë rrjetin e vet të perkohshëm të tubacioneve. Në rast se nuk ka mundësi lidhje me rrjetin e Ujësjetllësit, Kontraktori duhet të bëjë vete perpjekjet për furnizim me uje higjenikisht të pastër dhe të pijshëm për puntoret dhepunimet që do të kryhen gjatë zbatimit të projektit.

1.7. FURNIZIMI ME ENERGJI ELETRIKE

Energjia Elektrike që nevojitet për zbatimin e punimeve do të merret nga Rrjeti kryesorelektrik nepermjet një matesi në pikën më të afërt të mundshme e cila do të caktohet nga filiali KESH që e ka në përdorim linjen elektrike dhe do të jepet në përdorim me anë të kontratesperkatëse. Kontraktori duhet të parashikojë vete një gjenerator ose burim energjie të mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat për zbatimin me sukses të punimeve.

1.8. PIKETIMI DHE FOTOGRAFIMI I PUNIMEVE

Kontraktori, me shpenzimet e tij, do të bëjë ndërtimin e piketave dhe modinave sipas kërkesave të kushteve teknike të zbatimit dhe në përputhje me informacionin e dhënë nga Investitori. Ai do të jetë përgjegjës i vetëm për saktësinë dhe përpikërinë e vendosjes së tyre dhe matjeve në terren. Ai do të marrë masat për ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre nga dëmtimet që mund të behen gjatë zbatimit të punimeve dhe duhet të rivendosë çdo piketë të dëmtuar. Kontraktori do të jetë përgjegjës për të kontrolluar dhe verifikuar informacionin bazë që i është dhënë dhe në asnjë mënyrë nuk do të lehtësohet nga përgjegjësia e tij nëse në informacionin e tillë është i mangët, jo autentik dhe në mos përputhje me gjendjen aktuale. Kontraktori duhet të japë asistencën e tij teknike tek Punëdhënësi për kontrollin e piketave dhe modinave në terren. Kontraktori gjatë të gjithë fazave të zbatimit të punimeve duhet të bëjë në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme, fotografime të punës sipas udhëzimeve të Supervizorit në mënyrë që të demonstron progresin e punës, cilësinë e materialeve të përdorura dhe punimeve të kryera, kushtet e punës, etj. Shpenzimet për fotografimet duhet të jenë të parashikuara në shpenzimet administrative të Kontraktorit dhe nuk do të njihet ndonjë shtesë në lidhje me to.

1.9. MBROJTJA E PUNIMEVE, AMBIENTIT DHE PUBLIKUT

Kontraktori duhet të marrë të gjitha masat e duhura paraprake për mbrojtjen e puntoreve, publikut si dhe pasurive në dhe përreth sheshit të ndërtimit konform ligjeve në fuqi. Ai është përgjegjës i vetëm për respektimin e masave të sigurimit teknik, kodeve të ndërtësive dhendërtimeve të tjera duke përfshirë edhe ato arkeologjike, muzeale dhe historike. Kontraktori duhet të bëjë sigurimin e jetesës së punonjësve të saj, makinerive dhe punimeve pranë njerësprej shoqërive të Sigurimit që veprojnë në Shqipëri. Gjatë



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 0800 44 88
info@ukt.al
NIPT L72320033P

zbatimit të punimeve, Kontraktori me shpenzimet e veta duhet të vendosë dhe të mirëmbajë gjatë natës pengesa të ndryshme dhe drita të cilat do të parandalojnë në mënyrë efektive aksidente të mundshme që lidhen me këto punime. Kontraktori duhet të sigurojë pengesa të pershtatshme, shenja me drita të kuqe "rrezik" ose "Kujdes" si dhe vërtetues në të gjitha vendet ku punimet mund të shkaktojnë crregullime të levizjes normale të mjeteve ose që përbejnë në ndonjë mënyrë rrezik për publikun. Kontraktori, me shpenzimet e veta duhet të ndermarre të gjitha veprimet e mundshme për të siguruar ruajtjen e ambientit lokal nga ndotjet e ndryshme gjatë punës, nga zhurmat, nga demtimet e pemeve, etj. Për këto arsye, të gjitha makineritë dhe pajisjet që do të operojnë në terren duhet të jenë të pastra, të pershtatshme për transportin e materialeve pa shkaktoar derdhjen e tyre dhe konform rregullave dhe kushteve teknike të levizjes së tyre. Mosplotesimi i kushteve të mesiperme apo mos pajisja me leje perkatese të qarkullimit të mjeteve mund të sjellë edhe ndërprerjen e Kontrates.

1.10. TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI I MATERIALEVE

Transporti i materialeve nga Kontraktori duhet të bëhet me mjete transporti të pershtatshme të cilat kur të ngarkohen të mos shkaktojnë derdhje të ngarkesës. Ngarkesa gjatë transportit duhet të jetë e siguruar sipas kushteve dhe rregullave ligjore të transportit të mallrave. Cdo makinë që nuk plotëson këto kërkesa apo rregullat e qarkullimit do të hiqet nga Kantieri dhe do të zëvendësohet me një mjet tjetër të pershtatshëm. Të gjitha materialet që do të sjellë Kontraktori në objekt duhet të stivohen dhe të magazinohen në mënyrë të pershtatshme për tumbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet, etj. Ato duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të jenë të kontrollueshme nga Supervizori në çdo kohë.

1.11. LIBREZAT E MASAVE

Kontraktori duhet të përgatitë librezat e masave ku të jepen edhe të dhënat teknike për sasiedhe parametrat e tjere të materialeve të përdorura. Kontraktori duhet të përgatitë edhe seksionet e profilit gjatësor e terthor të rishikuar si dhe të gjitha detajet e nevojshme të pajisur me shënime perkatese që tregojnë llojin e tokës që haset gjatë punimeve të germimit. Të gjitha punimet e maskuara duhet të pasqyrohen në librezat e masave dhe të jenë pjesë e dokumentacionit teknik që do të dorëzohet së bashku me Objektin.

1.12. PASTRIMI PERFUNDIMTAR I SHESHIT

Në përfundim të punës, Kontraktori duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi me shpenzimet e tij të gjitha impiantet ndërtimore, makineritë, pajisjet speciale, materialet ndërtimore që kanë tepruar, mbeturinat e ndryshme, skeleritë, etj.



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 0800 44 88
info@ukt.al
NIPT L72320033P

1.13 DITARI I OBJEKTIT

Kontraktori është e detyruar të ketë pranë objektit DITARIN E OBJEKTIT i cili duhet të jetë i sekretuar (me nr.faqesh dhe i vulosur ngainvestitori).Ditari mbahet nga përgjegjësi teknik i objektit dhe plotësohet çdo ditë pune ku pasqyrohen punimet, problemet,kushtet e kohës etj.Ditari i paraqitet supervisorit dhe investitorit sa herë që ata vijnë në objekt për të bërë shenimet e tyre.Ditari është dokument themelor i dokumentimit të punimeve,afateve dhe problemeve si dhe udhëzimet për zgjidhjen e tyre.

2 - PUNIME DHERASH

2.1 TE PERGJITHSHME

Te gjitha germimet të çfarëdo lloji të tokës që ndeshen do të kryhen në thellësinë dhe gjerësinë e përcaktuar në vizatimet ose sipas udhëzimeve me shkrim të Supervisorit të Punimeve. Gjate germimit, materiali i përshatshëm për mbushje do të grumbullohet në një vend tepërshatshëm në një distancë të mjaftueshme nga bankinat për të shmangur mbingarkimin dhe të ruajë nga shembja anet e kanalit të germuar.Shtresa e sipërme e tokës do të grumbullohet veçmas për një ripërdorim të mëvonshëm nëse është e nevojshme. I gjithë materiali jo i përshatshëm do të dërgohet në një vend që është aprovuar nga Pushteti lokal dhe Punedhësi. Germimet në rrugë do të bëhen në mënyrë të tillë që pasazhi i rrugës të mos bllokohet nga materiali i germimit. Nivelimi do të bëhet në mënyrë të tillë që uji sipërfaqësor të mos vërshojë në kanale ose në pjesë të tjera të germuaradhe çdo sasi uji e mbledhur do të hiqet me anë të pompave ose me metoda të tjera të aprovuara por gjithmone në koston e Kontraktorit.

2.2 PASTRIMI I SHESHIT

Te gjitha sheshet ku do të germohet do të pastrohen nga të gjitha shkurret, bimët, ferrat,rrenjet, plehrat dhe materialet e tjera sipërfaqësore. Te gjitha këto materiale do të spostohendhe largohen në mënyrë të tillë që të jete e pëlqyeshme për Punedhësin.

2.3. GERMIMI I KANALEVE PËR TUBACIONET

Kanalet do të germohen në permatat dhe nivelin e treguar në vizatimet e perkatese ose nëpërputhje me instruksionet me shkrim të Supervisorit. Zeri i treguar në tabelën e vëllimeve(Preventiv) lidhur me germimet do të përfshijë çdo lloj kategorie dheu, nëse nuk do të jete specifikuar ndryshe. Germimi me krahe është gjithashtu i nevojshëm në afersi të intersektimeve me infrastrukturën e tjera për të parandaluar demtimin e tyre.

2.4 GERMIMI PËR STRUKTURAT



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 0800 44 88
info@ukt.al
NIPT L72320033P

Germimet do të behen në permasat dhe nivelin që përcaktohet në vizatimet ose nëninstruksionet e dhëna me shkrim nga Supervizori. Kur niveli i bazamentit është i arritur, Supervizori do të inspektojë dherat e tabanit dhe do të japë udhëzime për germim temetesh nëse ai i konsideron të nevojshme. Germimi do të bëhet në një mënyrë të tillë që të sigurojë që vepra do të qëndrojë në një bazament solid dhe shumë të pastër. Kur germimi duhet të mbulohet me vone nga ndertime tepërkohshme, Kontraktori duhet të vazhdojë menjëherë ndertimin e bazamentit pas rezultateve të kenësive të bazamentit.

2.5. MIREMBAJTJA E PUNIMEVE TË GERMIMIT

Të gjitha punimet e germimit do të mirembahen siç duhet ndërkohë që ato janë të hapura dhe ekspozuara. Pengesa të mjaftueshme si drita paralajmërore, shenja si dhe mjete të ngjashme do të sigurohen nga Kontraktori. Kontraktori do të jetë përgjegjës për ndonjë dëmtim personi ose pronësie për shkak të neglizhencës së tij ose mos marrjes së masave të duhura të Sigurimit teknik.

2.6. PERFORCIMI DHE MBROJTJA E PUNIMEVE TË GERMIMEVE

Nëse germimi i zakonshëm nuk është i mundur, gjatë germimeve duhet të vendosen strukturat mbajtëse për të parandaluar dëmtimet dhe vonesat në punë si dhe për të krijuar kushte të sigurta në punë. Kontraktori duhet të furnizojë dhe të vendosë të gjitha strukturat mbajtëse, mbulesa, trare dhe mjete të ngjashme në të nevojshme për sigurimin në punë. Strukturat mbrojtëse do të hiqen sipas avancimit të punës dhe në mënyrë të tillë që të parandalojë dëmtimin e punës së përfunduar si edhe strukturave të pasurive që janë pranë. Sapo këto të hiqen të gjitha boshllëqet që mbeten nga heqja e strukturave duhet të mbushen me kujdes dhe me material të zgjedhur dhe të ngjeshur.

2.7. HEQJA E UJRAVE GJATË PUNIMEVE TË GERMIMIT

Si pjesë e punës në zërat e germimit dhe pa kosto shtesë, Kontraktori duhet të ndërtojë të gjitha drenazhet e duhura dhe të realizojë kullimin me kanale, me pompim ose me kova si dhe të gjitha punët e tjera të nevojshme për të mbajtur pjesën e germuar të pastër nga ujrat e zezat dhe nga ujrat e jashtme deri në përfundimin e punës pa dëm. Kontraktori duhet të sigurojë të gjitha pajisjet e duhura të pompimit për punimet e tharjes së ujit si dhe personelin e duhur. Gjithashtu duhet të merren masat e duhura kundër përmytjeve dhe shirave të rrembyeshme.

2.8. MBROJTJA E SHERBIMEVE EKZISTUESË

Kontraktori do të ketë kujdes të vecantë për shërbimet ekzistuese që janë nën sipërfaqe të cilat mund të ndeshen gjatë zbatimit të punimeve dhe që kërkojnë kujdes për mbrojtjen e tyre sipas të Kanalizimeve, të ujësjetës, kabllot elektrikë, telefonikë si dhe bazamentet e strukturave që ndodhen pranë Kontraktori.



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 0800 44 88
info@ukt.al
NIPT L72320033P

do të jete përgjegjës për demtimin e ndonjë prejsherbimeve të mesiperme dhe duhet të riparojë me shpenzimet e veta

2.9. SHTRATI I TUBACIONEVE

Materialet që do të përdoren për shtratin e tubave (poshtë dhe sipër tubacionit) duhet të jenë të pastërta (pa pluhura dhe perberesa druri apo mbeturina të çdo lloji. Materiali për shtratin do të shpërndahet dhe nivelohet në mënyrë të tillë që të krijojë një shtrat të vazhdueshëm dhe uniform për mbështetjen e tubave në të gjitha pikat që nga puseta deri tek bashkimet. Do të jete e lejueshme që shtresa e niveluar të preket lehtësisht gjatë tërheqjes së materialit bashkues të tubave ose çdo pajisje tjetër ngritëse. Shtrimi i tubave do të bëhet në nivelin, thellësinë dhe përmasat e treguara në vizatime. Materiali për shtratin e tubave do të nivelohet mirë. Pasi të jete niveluar çdo tub, vendosur në linjë dhe në pozicionin e fundit të materialit të shtetit të dy anët e tubit do të mbushen dhe ngjeshen me material të përzgjedhur në mënyrë që tubat të mbahen në pozicion të përshtatshëm dhe në linjë të drejtëgjatë të gjithë procesit të bashkimit dhe shtrimit të tyre. Materiali i shtratit do të hidhet në të dy anët e tubit njëkohësisht dhe vazhdimisht dhe do të ngjeshet në mënyrë uniforme për të parandaluar zhvendosje gjatësore.

2.10. NGJESHJA E MBUSHJEVE DHE MBULIMET

Mbushja dhe mbulimi i kanaleve do të bëhet pasi të ketë përfunduar germimi dhe pastrimi i kanaleve. Materiali mbushës do të përgatitet sipas kushteve të dhënë më poshtë duke u kujdesur për lageshtinë dhe përzierjen e tij dhe me pas përhapet dhe ngjeshet në objekt me rulvibrues, me ngjeshës të posacem dore ose mekanike. Përpara ngjeshjes, përmbajtja e lageshtisë duhet të jete në nivelin e kërkuar, duke e lagur në se është i thatë dhe duke e tharë se është i lagur. Mbushjet dhe mbulimet do të jenë të shtresëzuara në mënyrë të vazhdueshme dhe gati horizontale për të arritur trashësinë e treguar në vizatime. Mbulimi me materiale sipërfaqësore nuk është i lejueshëm. Shtresa e sipërme e fundit të mbushjes dhe mbulimit duhet të mbahet në gjendje sa më të sheshtë. Në vendet ku kërkohet mbushje ose mbulim shtesë, lartësia e treguar në vizatime për mbushje dhe mbulim do të rritet. Materiali mbushës nuk duhet të përmbajë llumra, boshllëqe apo parregullsi të tjera. Punimet e ngjeshjes do të testohen me anë të metodave të testimit të ngjeshjes së dheut (Provat e materialit mbushës). Pajisjet e ngjeshjes dhe kushtet e ngjeshjes do të përcaktohen në varesi të llojit të dheut. Në rastin e ngjeshjes së shtresave kohezive (argjilave) materiali do të përhapet në shtresë horizontale me trashësi të çdo shtrese jo më shumë se 15 cm. Lageshtia do të jete e njëjte për çdo shtresë dhe në çdo pike.

2.11. MATERIALET E PËRDORURA PËR MBUSHJE

Materialet që do të përdoren për punime mbushëse do të jenë të lira nga guret dhe pjesë të forta me të mëdha se 75 mm në çdo permase dhe gjithashtu të pastër nga perberesa druri apo mbeturina të çdo lloji. Materiali mbushës do të ngjeshet sipas mënyrës së treguar me sipër dhe aprovimit nga Supervizori.



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 0800 44 88

info@ukt.al

NIPT L72320033P

Dherat me permbajtje te tepert organike nuk do te lejohen te perdoren. Materiale me madhesi granulare me teper se 75 mm nuk mbulohen nga ky klasifikim. Ne rast se materialet e mbushjes bredna zones se germimit nuk jane te mjaftueshme ne sasi dhe cilesine e duhuratehere do te merren materiale nga zona te tjera te aprovuara nga Supervizori i Punimeve. Kontraktori duhet te bjere dakord me pronaret e tokes nga ku do te merret dheu per mbushjeper te marre sasine e kerkuar te dheut me shpenzimet e veta.

2.12. MATJA E VOLUMEVE

Te gjitha zerat e punimeve te tokes do te maten ne volum. Matja e volumeve do te bazohet nedimensionet e marra ne vizatimet. Cdo punim pertej limiteve te percaktuara ne keto vizatime,nuk do te paguhet, nese nuk percaktohet me pare me shkrim nga Supervizori.





Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 0800 44 88
info@ukt.al
NIPT L72320033P

3 - MATERIALET HIDRAULIKE

3.1 TUBAT DHE PJESËT SPECIALE HDPE 100

3.1.1 - Kërkesat e Përgjithshme dhe Standartet Teknike Referuese

Për linjat e Ujësjetës do të përdoren tuba dhe pjesë speciale plastike prej materiali Polietileni me densitet të lartë (HDPE100). Diametrat e tubave do të jenë në funksion të sasise llogaritese të ujit të pijshëm dhe shpejtesise së levizjes. Gjatesia e tubave mbi –110 duhet të jetë 6-12 m kurse diametri dhe spesori duhet të jenë sipas të dhënave në vizatimet teknike. Spesori duhet të jetë në përputhje me kërkesat e projektit për presionin e punës së tubave dhe shkallën e Dimensionimit Standart (SDR=11-17). Ovaliteti i tubave nuk duhet të jetë më i madh se 1,5% Tubat dhe pjesët Speciale HDPE duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat e standarteve teknikeperkatëse si më poshtë:

- PrEN 12201 (Sistemet e tubacioneve Plastike të furnizimit me ujë prej Polietileni),
- ISO 1183 (Matjet e Densitetit të materialit),
- ISO 3607, (Tolerancat mbi diametrin e jashtëm dhe trashësinë e mureve)
- ISO 3663 (Dimensionet e Fllanxhave për tubat dhe pjesët speciale të PE)
- ISO 4440, (Përcaktimi i shkallës së rrjedhjes së materialit PE për tubat dhe pjesët speciale
- DIN 8075. (Kërkesat e Përgjithshme të Cilesisë së Tubave HDPE – Testimi)

Tubat e HDPE 100 për furnizimin me ujë duhet të sigurojnë rezistencë perfekte ndaj korrozionit, rezistencë të lartë ndaj agjenteve kimike, peshë të lehtë, mundësi të thjeshtariparimi e transporti, ngjytje të thjeshtë dhe të shpejtë, jetëgjatësi mbi 20 vjet. Të dhënat mbi diametrin e jashtëm të tubit, presionin, emrin e prodhuesit, standartin që i referohen, SDR, viti i prodhimit, etj duhet të jepen të stampuara në çdo tub në çdo 2 m. Tubat do të furnizohen në objekt vetëm pas Aprovimit me shkrim nga Supervizori përplotësimin e kërkesave të mesiperme në lidhje me cilësinë, llojin dhe origjinën e tyre. Pas përfundimit të Instalimit të tubave, duhet të bëhet një testim për presionin e punës së tubave I cili duhet të jetë sipas Kushteve teknike të Zbatimit dhe në prezencë të Supervizorit.

3.2 - Kërkesat Teknike për Materialin e Polietilenit

Materiali i Polietilenit prej të cilit do të prodhohen Tubat dhe pjesët speciale të tyre është një produkt hidrokarbur me formulë kimike CH₂-CH₂. Ky material duhet të jetë i sigurt për shëndetin njerëzve dhe i aprovuar nga Institucionet përkatëse ligjore si IIP, DVGË apo Institute të tjera të afta dhe të aprovuara për testimin e cilësisë së materialeve plastike. Vetitë e Materialit të HDPE duhet të jenë si më poshtë:

- Densiteti > 0,95 g/cm³
- Koeficienti i zgjerimit linear 0,13 mm / m * K
- Konduktiviteti Termik në 20 gradë celsius 0,38 W / m * K
- Indeksi i Rrjedhjes MFI në 190 gradë celsius/50 N 0,4-0,5 g/ 10 min
- Sforcimet 25 N/mm³



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 0800 44 88
info@ukt.al
NIPT L72320033P

- Rezistenca Siperfaqesore $>10 \times 10^{14}$ Omega
- Shkalla e rrjedhshmerise 127 grade celsius
- Terheqja ne thyerje $> 600 \%$
- Moduli i perfshirjes ne kthime apo perkulje 800 N/mm²

3.3. - Dokumentacioni Teknik Shoqerues

Tubat dhe pjeset Speciale HDPE duhet te jene te shoqeruar me dokumentacionin teknik perkates te kerkuar nga Standartet e mesiperme si:

- Certifikata e Cilesise ISO 9001/14001 ose ekuivalente
- Manual teknik te Tubave dhe te pjeseve speciale te prodhuesit te shoqeruar me manualin e operimit, instalimit, te mirembajtjes si dhe te dhenat teknike te tyre.
- Manualin Teknik te Pajisjeve bashkuese te tyre te shoqeruar me te dhenat e menyres se bashkimit, procesit te ngjitjes, kontrollit dhe testimit gjate procesit te Instalimit.

Firma zbatuese e punimeve duhet te paraqese te gjitha certifikatat dhe dokumentat e mesiperme per aprovim tek Supervizori perpara furnizimit dhe instalimit te tyre ne objekt.

3.4. - Transporti dhe Magazinimi i tubave

Transporti i tubave dhe pjeseve speciale duhet te behet nga automjete te pershtatshme pertransportin e tyre te cilat duhet te jene te pajisura me mbrojtese anesore me lartesi te pakten $H = 0,6$ m. Tubat duhet te jene te vendosur drejt, te mbeshtetur tek njeri tjetri dhe te mbuluar me nje mbulesë per mos demtimin e tyre nga rrezet e diellit. Ngarkimi dhe shkarkimi i tyre duhet te behet me kujdes dhe duke shmangur perplasjet e tyre, sforcimet mekanike apodemtime te tjera te cilat do te jene pergjegjesi e vete Kontraktorit. Gjate te gjithë kohes se magazinimit, transportimit te tyre ne objekt dhe derin e momentin instalimit, tubat duhet te jene te mbyllur me tapa plastike fundore te posacme te cilat nuk duhet te hapen dhe te lejojne futjen e ujrave te ndotura, pislleqeve apo materialeve tendryshme te demshme ne to. Zona e magazinimit te tubave dhe pjeseve speciale duhet te jete rrafshet, e paster, pa zhavorre apo gure te mprehte, e rrethuar dhe e mbrojtur. Lartesia evendosjes se tubave nuk duhet te jete me e madhe se 1 m dhe te gjitha materialet nuk duhet te jene te ekspozuara ndaj diellit.

3.5 Kërkesa te Pergjithshme dhe Standartet Teknike per Valvolat

Valvolat duhet te sigurojne nje izolim te sigurt te sistemit ndaj rrjedhjeve te ujit dhe njemirembajtje sa me te vogel. Ato duhet te perballojne goditjet mekanike gjate punes dhe rritjene presionit qe shkaktojne grushtet hidraulike. Valvolat duhet te plotesojne kerkesat e projektit te detajuar dhe kerkesat e standartit ISO 9001. Valvolat duhet te kene nje garanci tecertifikuar te pakten deri ne 1 vjet nga prodhuesi i tyre. Valvolat qe do te perdoren do te jene te presioniot PN 16. Cdo Valvol duhet te jete e shoqeruar me tabelen metalike ku te jepen dimensionet e saj, presioni i punes, etj. Duhet theksuar se Valvolat ne



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 0800 44 88

info@ukt.al

NIPT L72320033P

sistemin e shpërndarjes së ujit duhet të jenë të llogaritura dhe të testuara me presione pune mbi 1,5 here të presionit të punës të tubave.


3.6 Venia nën presion

Prova hidraulike duhet të jetë jo më pak se dy here, prova e parë bëhet para mbulimit, prova e dytë bëhet mbas mbulimit të tij.

- Prova bëhet për pjesë të shkeputura 400-800 mL.
- Prova bëhet pa hidrante, pa valvola sigurimi etj.
- Të gjitha degezimet dhe daljet e lira duhet të jenë të mbyllura.
- Tubacionet duhen të mbahen në provë jo më pak se 24-28 orë

3.7 Dezinfektimi

Mbasi të bëhet prova e rrjetit të ujësjetllës të ri tubacioni do të shpëlarë dhe më pas duhet të desinfektohet me klor me doze 20 mg/l për 24 orë, mbas dezinfektimit bëhet shpëlarja dhe marrja e analizave nga Drejtoria e Epidemiologjisë së Tiranës e cila jep dhe lejen në shfrytëzim të rrjetit.





Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 0800 44 88
info@ukt.al
NIPT L72320033P

4. Pusetat

Pusetat do të jenë dhoma ku do të vendosen valvolat. Ato duhet të ndertohen në mënyrë të tillë që të krijojnë kushtet e përshtatshme për operimin e pajisjeve që do të instalohen brenda tyre. Për sa më sipër gjatë përcaktimit të përmasave të tyre duhet të kihet parasysh ndodhjen rregullat e mëposhtme:

- Largesia nga fundi i pusetes deri tek buza e poshtme e gotës ose e fllanxhës të jetë jo më pak se 10 cm
- Largesia nga fllanxha deri tek muri në drejtim të aksit duhet të jetë jo më pak se 20 cm kurse në drejtim tërthor me aksin jo e pak se 25 cm nga buza e jashtme e fllanxhës
- Largesia ndërmjet dy faqeve të jashtme të dy fllanxhave duhet të jetë jo më pak se 40 cm.
- Për rastet kur në pusete instalohen më shumë se 2 valvola kontrolli duhet të ruhen normat që jepen për çdo valvole në të gjitha drejtimet

Përmaset e pusetave janë dhënë në vizatimet përkatëse për çdo pusete në funksion të organizimit të valvolave, pjesëve speciale që janë instaluar në to. Forma e pusetave duhet të jetë drejtkëndëshe konform kërkesave të projektit por në të gjitha rastet e përshtatshme për një punë normale gjatë operimit me valvolat e instaluar në të.

Valvolat e kontrollit dhe pjesët speciale rekomandohen të vendosen pasi të ketë përfunduar ndërtimi i dyshemës së pusetes dhe përpara se të ndertohen muret e saj.

Kontraktori do të ndërtojë pusetat në pozicionin, vendin dhe përmaset e dhëna në projekt.

Ndërtimi i pusetave duhet të bëhet sipas një rradhe të caktuar punë duke filluar nga ndërtimi i dyshemës së saj dhe pas instalimit të valvolave dhe pjesëve speciale që janë parashikuar të vendosen në të të vazhdohet me ndërtimin e mureve dhe të mbulesës së pusetes. Në të gjitha punimet e mësipërme duhet të bëhen nën mbikqyrjen e Supervizorit të Punimeve. Përparafillimit të ndërtimit të pusetes duhet të hapet gropa ku do të bëhen punimet e ndërtimit të dyshemës me përmasa 10-20 cm më të mëdha se përmasat e pjesës së jashtme të mureve të pusetes. Pasi hapet gropa, toka duhet të përgatitet në mënyrë të tillë që të sigurojë themele të përshtatshme dhe të qëndrueshme. Për këtë arsye toka pas bazamentit të pusetes duhet të tregëzohet. Në rast se toka nuk siguron një qëndrueshmëri të pranueshme atëherë do të përdoret një shtresë zhavorri me trashësi më të madhe se 15 cm ose një shtresë butobetoni M100 me trashësi betoni më të madhe se 10 cm. Dyshemeja e pusetave duhet të bëhet me beton M150. Në rast se pusetat ndertohen në toka të lagëta, trashësia e dyshemës prej betoni e pusetes duhet të jetë jo më pak se 12 cm.

Muret e pusetave të jenë prej betoni M 250.
Soleta dhe puseta të jenë prej b/a M 250.

Në muret e pusetave duhet të vendosen ganxha prej hekuri të rrumbullakët me diametër jo më të vogël se 20 mm dhe në largësi ndërmjet tyre 30 - 40 cm të cilat do të shërbejnë si shkallë për hyrjen në fund të tyre.



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 0800 44 88
info@ukt.al
NIPT L72320033P

Ne rast se puseta do te jete ne nje rruge te pambaruar, korniza e hekurit dhe kapaku nukvendosen deri sa te behet asfaltimi i rruges. Pusetat duhet te hidroizolohen ne menyre te tilleqe te mos lejohet futja e ujrave nentokesore ne to dhe te sigurohet mbajtja e paster dhe e thatee ambienteve te brendshme te saj.

Mbulimi i pusetave do te behet me soleta betonarmeje sipas permasave dhe llogaritjeve tebera nga projektuesi. Ato do te vendosen mbi muret e pusetave e drejtimin e dhene ngaprojektuesi megjithese rekomandohet qe te mbeshteten ne muret qe nuk kane hyrje ose daljete tubacioneve kryesore. Ne keto soleta do te vendosen kapake prej gize ne perputhje me DIN1239.

Cmimi njesi per pusetat perfshin furnizimin dhe vendosjen e te gjitha elementeve te betonit(inertet, uji, cemento, etj) forcimin e bazamentit te pusetes, ndertimin e mureve te pusetes sebashku me armaturat perkatese, ndertimin dhe vendosjen e soletes sepusetes si dhe sheshimin e siperfaqes perreth pusetes, ngarkimin, shkarkimin dhe transportin ematerialeve dhe pajisjeve te nevojshme gjate ndertimit te saj, etj. Ne kete cmim njesi nukperfshihet kostoja per germimin e gropes si dhe cmimi njesi per furnizimin dhe vendosjen eValvolave dhe pjeseve te tjera speciale te cilat jane parashikuar ne zerat e tjere te punimeve.

MBESHTETJA TEK KUSHTET TEKNIKE

Per vec ketyre specifikimeve jane gjithashtu te detyrueshme te gjitha rregullat e pershkruara ne KTZ egzistuese ne fuqi per ujesjellesat.

Per te gjithë zerat e punimeve, te zbatohen me rigorozitet kushtet teknike te zbatimit te punimeve, duke perdorur materiale qe plotesojne standartet ne fuqi.

Projektues

Ing.Amarilda NANO

Përgjegjëse e Projektit

Ing.Albana MILO



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 0800 44 88

info@ukt.al

NIPT L72320033P

